



Pranimja / Dorezimi Prilimje / Prilato Received / Delivery	31.12.2021	1	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/STCK	6477/2021		1/9



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.951/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.951/2021 të datës 22.11.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga "Ismail Dumoshi"nr.5, Komuna e Prishtinës, kundër Vërejtjes me shkrim me numër Nr.Prot.1882/2021 të datës 03.11.2021 të Zëvendës Drejtorit të Departamentit Ligjor të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 31.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar** ankesa me numër A.nr.951/2021 e datës 22.11.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. SHFUQIZOHET** Vërejtja me Nr.Prot.1882/2021 e datës 03.11.2021 e zëvendës drejtorit të Departamentit Ligjor të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve e shqiptuar ndaj ankueses.
- III. OBLIGOHET** Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Punëve të Financave, Punës dhe Transfereve, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke nxjerrë vendim për fshirjen e Vërejtjes me numër të protokollit Nr.1882/2021 të datës 03.11.2021 të shqiptuar nga Udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë dhe largimin e saj nga dosja e ankueses.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankueses e punësuar në pozitën "Zyrtare ligjore", sipas akt emërimit të datës 07.12.2011, në Departamentin ligjor të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me datën 03.11.2021 Zëvendësues i Drejtorit të Departamentit Ligjor të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve i ka shqiptuar masën disiplinore Vërejtje me shkrim.



Ankuesja e pakënaqur me Vërejtjen e shqiptuar nga ana e Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit Ligjor të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me datën 22.11.2021, ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:5566/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vërejtjes me shkrim me Nr.Prot.1882/2021 të datës 03.11.2021 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit Ligjor të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me pretendimet ankimore se vërejtja e shqiptuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave ligjore, shkelje procedurale dhe vlerësim të gabuar, jo real dhe jo të plotë të gjendjes faktike e shëndetësore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, me datën 25.11.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me datën 03.12.2021 përmes Divizionit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 22.11.2021 me Nr.Prot:5566/2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtja me numër të protokollit Nr.Prot.1882/2021 e datës 03.11.2021; E-maili zyrtar i datës 29.10.2021; E-maili zyrtar i datës 25.10.2021; Udhëzim nga QKMF –Prishtinë i datës 07.09.2021;Raportin mjekësor të datës 27.09.2021;Udhëzim nga QMF III- i datës 13.10.2021; Raport kthyes nga laboratorit i datës 14.10.2021; Raport specialistik i datës 19.10.2021; Vijimi në punë i ankueses për datën 19.10.2021; e-maili zyrtar i datës 19.10.2021; Raport specialistik i datës 10.11.2021; E-maili zyrtar i datës 10.11.2021; Raport mjekësor i datës 11.11.2021; Raport mjekësor i datës 14.11.2021; Shkresë nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës e datës 11.11.2021; E-maili zyrtar i datës 22.10.2021;E-maili zyrtar i datës 25.10.2021; E-maili zyrtar i datës 25.10.2021; E-maili zyrtar i datës 25.10.2021; Raport i ekzaminimit mikrobiologjik i datës 15.10.2021; Raport me numër të protokollit Nr.Prot.3581; E-maili zyrtar i datës 19.10.2021; E-maili zyrtar i datës 25.10.2021; E-maili zyrtar i datës 25.10.2021; E-maili zyrtar i datës 25.10.2021; E-maili zyrtar i datës 25.10.2021; E-maili zyrtar i datës 25.10.2021; E-maili zyrtar i datës 25.10.2021; E-maili zyrtar i datës 29.10.2021; Shkresë e datës 08.12.2021 e dorëzuar nga ankuesja si prova shtesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raport specialistik i datës 26.11.2021;Analizat laboratorike të datës 26.11.2021; Emaili zyrtar i datës 14.12.2021; Procesverbalet në bazë të vendimit nr.15/2021 pika 1.2. 1.1.1.1,1.2 dhe 1.1 mbi pranim dorëzimit e dokumenteve origjinale (me vule origjinale arkivore); Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 25.11.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 03.12.2021 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërim i datës 07.12.2011 i ankueses së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Lista mbi ardhje-vajtje në punë për ankesën e datës 05.01.2022. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka vërtetuar se ankesa e ankueses **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e anekseve ka konstatuar se Zëvendësues i Drejtorit të Departamentit Ligjor të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me datë 03.11.2021 i ka shqiptuar masën disiplinore „Vërejtje me shkrim” ankueses me pretendimin se ankuesja me veprimin e saj ka kryer shkelje të lehte të disiplinore respektivisht sjellje e parregullt , gjate kohës se punës , me mbikëqyrësit, koleget, vartësit dhe me publikun sipas nenit 46 paragrafit 4 nën paragrafit 4.3 Ligjit nr. 06/L – 114, për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit respektivisht komunikimet përmes e-mailit dhe konkretisht e-mailin e datës 22.10.2021 dhe datës 25.10.2021 ndërmjet ankueses dhe udhëheqësit të drejtpërdrejtë të saj lidhur me kryerjen e detyrave të punës lidhur me klasifikimin e dokumenteve të departamentit ligjor për ne arhivë



në ish objektin e Ministrisë së Financave, dhe ka konstatuar se ankuesja po atë ditë e ka njoftuar udhëheqësin e saj të drejtpërdrejtë lidhur me atë se nuk ka pasur mundësi ta kryej këtë punë pasi që e njëjta ka pasur kontrollë mjekësore pas paraqitjes së problemeve shëndetësore në vendin e punës, gjendje kjo e cila vërtetohet edhe me raporte mjekësor të datës 19.10.2021 sipas të cilit e njëjta është diagnostikuar nga mjeku specialist i kirurgjisë abdominale. Ankuesja po ashtu për mungesat në punë në lidhje me problemet e paraqitura shëndetësore, çdo here përmes e-mailit zyrtar e ka njoftuar udhëheqësin e saj të drejtpërdrejtë si dhe i ka arsyetuar me raporte mjekësore të mjekëve specialiste të fushës përkatëse.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që Zëvendësuesi i Drejtorit të Departamentit Ligjor të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me rastin e shqiptimit të masës disiplinore „Vërejtje me Shkrim“ të datës 03.11.2021 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore që përcaktojnë procedurën disiplinore dhe masat disiplinore për nëpunësit civil respektivisht duke mos i konstatuar drejt elementet e përgjegjësisë disiplinore, rrjedhimisht nuk ka konstatuar saktë përgjegjësin disiplinore të përcaktuar me dispozitat e Ligjit nr. 06/L – 114, për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, nenin 45 ku përgjegjësia disiplinore është përcaktuar si në vijim: **Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”** andaj në rastin konkret në bazë të provave të lëndës këto dispozita nuk janë zbatuar, sepse nuk është vërtetuar saktë ndonjë veprim i paligjshëm i ankueses apo qellim jo i mire me rastin e dërgimit të e-mailit të datës 29.10.2021, sepse ankuesja vetëm ka shpjeguar procedurat dhe praktikën brenda institucionit si kanë shkuar në lidhje me klasifikimin e dokumenteve dhe elaborimin e faktit që edhe përkundër problemit shëndetësor të paraqitur në punë, ankuesja me ndihmën e kolegut ka shkuar dhe ka bërë sistemimin e follderëve dhe e njetja detyrat e saj i ka përfunduar me datën 29.10.2021, ku përmes e-mailit zyrtar i ka dërguar me vulë origjinale tek udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë, po ashtu ankuesja përmes ankesës së dërguar në Këshill me datën 22.11.2021, ka shpjeguar se gjatë dërgimit të e-mailit përmes postes elektronike pa dashje e ka përfshirë edhe emrin e zyrtarit në pozitën “Zyrtar i lartë për marrëdhënie dypalëshe” në Ministrinë e Punëve të Jashtme, në vend të kolegut të saj në pozitën “Zyrtar i depos” pranë Ministrisë së Financave, gjë e cila dëshmohet edhe përmes sistemit të „address book” në lidhje me dërgimin e e-mailave zyrtarë sepse të njëjtit figurojnë afër sipas renditjes së emrave edhe në sistemin e komunikimit elektronik zyrtar, andaj Kolegji konstaton se e-mili i datës 29.10.2021 i dërguar nga ankuesja nuk ka pasur për qellim shpërndarjen e informatës jashtë institucionit e aq me pak në lidhje me shëndetin e saj, por dihet se ka qene gabim teknik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se masa disiplinore “vërejtje”, me numër të protokollit Nr. Protk.1882/2021 e datës 03.11.2021 e shqiptuar ndaj ankueses, është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, sepse nuk është shqiptuar në raport të drejtë me shkeljen e kryer, rrjedhimisht udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses, ka vepruar në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: **“Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil”**, e që në rastin konkret nuk është vërtetuar shkelja e pretenduar nga ana e udhëheqësit të ankueses, nuk është informuar lidhur me shkeljen e supozuar krejt kjo edhe në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 1, 2, 3 dhe nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 si dhe nenin 13 paragrafin 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të vërejtjes me numër të protokollit Nr. Prot.1882/2021 të datës 03.11.2021, e shqiptuar nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses, ka konstatuar se e njëjta është nxjerrë në kundërshtim me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.4

të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. në të cilin përcaktohet se: “1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ”, pasi që nuk përmban udhëzimin lidhur me këshillën juridike për palën dhe si i tillë edhe është i paligjshëm dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: “Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: “Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë– Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.951/2021

Ardita Perçuku-Shyti


Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në dhe Financave, Punës dhe Transfereve dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.